

V E N D I M
Nr. 513, datë 21.9.2000

PËR DETYRIMIN E MJEKËVE, QË DUAN TË SPECIALIZOHEN

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të paragrafit të tetë, të nenit 13, dhe të paragrafit të dytë, të nenit 38, të ligjit nr.8461, datë 25.2.1999, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Mjekët e përgjithshëm, të diplomuar në fakultetin e Mjekësisë, në Universitetin e Tiranës kanë të drejtë të konkurrojnë për specializim pasuniversitar në mjekësi vetëm pasi të kenë punuar një vit në vendet e lira të punës në rrethe, të përcaktuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Instituti i Sigurimeve të Kujdesit shëndetësor.

2. Kanë të drejtë të konkurrojnë, pa përmbushur detyrimin e mësipërm, ata mjekë të përgjithshëm, që kërkojnë të specializohen në degët “Mjek i familjes”, “Mjek i shëndetit publik”, dhe “Anatomi Pathologjike”.

3. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Arsimit dhe Shkencës të nxjerrin aktet, në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta